**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

**OSHP: 2023/0964**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga,Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.T.P "Hajdini Comerc", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Agjencia Qendrore e Prokruimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimor" me numër të prokurimit UA/2016-23-9179-1-1-1, me 15/03/2024, mori:

# Vendim

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit ekonomik,N.T.P "Hajdini Comerc "me numër të protokollit; 2023/964, kundër vendimit të autoritetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " Furnizim me artikuj ushqimor", për lot 3 dhe lot 5, aktiviteti prokurimit: UA/2016-23-9179-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit.

2. Anulohet "Njoftimi mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues", i datës 16.11.2023, për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit titull " Furnizim me artikuj ushqimor", për lot 3 dhe lot 5, të prokurimit: UA/2016-23-9179-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe lënda kthehet ne Ri-vlerësim.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

# Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me dt. 29.08.2023 AK ka publikuar, Njoftimin Paraprak, kurse me dt. 13.09.2023 ka publikuar Njoftimin për kontratë, aktiviteti i prokurimit është ndarë në gjithsej 7 llote, kurse nuk ka pasur kufizim sa i përket shpërblimit të lloteve.

Me dt 24.10.2023 është bërë Hapja e ofertave dhe për llotet ankuese kishin aplikuar Operatoret ekonomik si në vijim; Për lot 3 kishin ofertuar gjithsej 3 OE kurse për lotin 5 kishin ofertuar 3 operator ekonomik, në ë dy lotet ka aplikuar edhe OE ankues.

Me dt 16.11.2023 AK- Agjencia Qendrore e Prokurimit, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se ku për kontratë Lot 3 ka rekomanduar Grupin e Operatorëve Ekonomik Dauti Komerc SH.P.K.; Dauti Komerc AD Saraj Shkup, Gërlicë, 70000, Ferizaj, Kosovë vlera e ofertës 555,205.00€ dhe për lot 5 ne vlerë prej 886,902.00€.

Me dt 16.11.2023 OE ankues parashtron kërkesë për qasje në dokumente Publike të cilën e realizon në autoritet me dt 17.11.2023 duke marr dokumentacionin sipas kërkesës me USB,

Me dt 21.11.2023 OE ankues parashtron Kërkesë për Ri-shqyrtim ndërsa AK me dt 23.11.2023 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim si të pa-bazuar, duke e arsyetuar vendimin e tij për të gjitha pretendimet e OE ankues.

Me dt 01.12.2023 OE i pakënaqur me përgjigjen e AK-së paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit ( OSHP).

Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit. gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës, furnizim vlera totale e parashikuar e kontratës: 6,830,000.00€ kurse vlera e parashikuar për llotet ndaj të cilave është parashtruar ankesa janë për lot 3 është 660,000.00€ dhe vlera e parashikuar për lot 5 është 1,050,000.00€

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*-Administrimi dhe vlerësimi i provave-*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin shqyrtues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër**.**

*Pretendimet ankimore te Operatorit Ekonomik N.T.P "HAJDINI COMERC 2023/0964 si në vijim:*

Autoriteti Kontraktues AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT, nuk e ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim në përputhje me kërkesat ligjore, ngase nuk i ka trajtuar pretendimet tona ankimore ne lidhje me deklaratat për themelimin e grupit, sa i përket nenit 71, paragrafit 2 të LPP-se, sepse AK, nuk ka ofruar kundër argument, por në mënyre gjithëpërfshirëse është arsyetuar duke luajtur rolin e avokuesit të kompanisë se propozuar për dhënie të kontratës.

Madje, AK nuk e merr për bazë interpretimin e KRPP-se, të datës 22.11.2022, të pyetja e 18, sa i përket kapaciteteve teknike dhe profesionale, ku nder të tjera dhe, në lidhje me themelimin e grupit ne mënyrë të qartë dhe me mbështetje ligjore interpreton situata të ngjashme: E pa

pranueshme do të konsiderohej nëse operatori ekonomik me degët e saja dorëzojnë individualisht tenderë në një aktivitet prokurimi që ka për qëllim dhënien e një kontrate publike, sepse një pjesëmarrje e tillë do të dëmtonte konkurrencën, në fakt do të krijonte konkurrencë të pa ndershme.

Pra, në rastin konkret Grupi i OE "Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A. me seli në Shkup, nuk i ka plotësuar kapacitetet teknike dhe profesionale të nenit 69, paragrafit 8 të LPP-se, sepse është mbështet në kapacitet e kompanisë - Qumështores "Abrazen" LLC, por që, Qumështorja "Abrazen" LLC ka marrë pjesë në Grup me "FANEXT" shpk & "ABRAZEN" LLC në të njëjtin tenderë, përkatësisht në Lot 3: Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit.

Prove 1: Dokumenti Licencensa AUV dhe dok.tjera në emër të ABRAZEN LLC

Në lidhje me ketë dhe, po ti referohemi dispozitave të nenit 71, paragrafit 2 të LPP-së dhe interpretimit të KRPP-së, është evidente se për të njëjtin Lot 3, Qumështorja "Abrazen" LLC, është pjesëmarrëse direkt të GOE "FANEXT" shpk & "ABRAZEN" LLC dhe Indirekt të GOE "Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A, prandaj, referuar edhe interpretimit të KRPP-së, forma e tillë e pjesëmarrjes në të dy grupet direkt dhe indirekt konsiderohen të pa pranueshme sepse krijon konkurrencë të pa ndershme, për me tepër është shkelje e dispozitave të nenit 71 paragrafit 2 të LPP-se, sepse, nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm. Në rastin konkret, pjesëmarrja e kompanisë Qumështorja "Abrazen" LLC në të dy grupet, qoftë ne mënyre drektë apo indirektë, krijon konkurrencë të pa ndershme dhe rrjedhimisht, të dy GOE duhet të eliminohen sepse konsiderohen të pa përgjegjshëm!

Mirëpo, AK nuk e trajton pretendimin tonë të ngritur në kërkesën për rishqyrtim, në përputhje me dispozitat e LPP-se dhe interpretimit të KRPP-se, sepse i terë qëllimi i aktit të tillë siç është kërkesa për rishqyrtim, ka për qëllim që t'i vejë AK në një pozicion për ti ri-shikuar vendimet e tyre, për ti korrigjuar ato dhe për të nxjerrë vendime në bazë të meritave dhe me mbështetje ligjore dhe interpretimeve ligjore, por që, AK në ketë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 dhe 2.8 të LPP-së, sepse nuk e merr për bazë interpretimin ligjor të lartë cekur dhe, rrjedhimisht, për shkak të trajtimit jo të duhur të pretendimeve tona shkel edhe dispozitat e nenit 108/A par 8, nen par 8.4, sepse refuzon kërkesën pa i shqyrtuar siç duhet pretendimet tona, pa e shqyrtuar interpretimin e KRPP-se dhe pa i arsyetuar ato në aspektin ligjorë.

Madje, AK tejkalon kompetencat ligjore, sepse pas hapjes së ofertave, me kërkesë të AK, pranon një deklaratë nga "Dauti Komerc" Shpk, me të cilën deklaratë, OE në fjalë deklaron se, nëse shpallemi fitues të këtij aktiviteti për Lot 3, do të furnizojmë me produkte të prodhuara nga kompania "Abrazen" LLC. Për me tepër, kjo forme e kërkesës e bërë nga AK, pas hapjes së ofertave krijon precedent të rrezikshëm, sepse pas hapjes së ofertave zbulohen politikat e kompanive dhe çmimet e tyre e që në ketë fazë është e pa pranueshme dhe e pa drejtë të kërkohen dokumente të tilla.

Prandaj, ky veprim i AK është ne kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 59, paragrafit 2 dhe nenit 72, paragrafit 3 të LPP-se, sepse nuk duhet të pranohet një dokument, ekzistenca e te cilit nuk ka qenë e fiksuar para dorëzimit të ofertave. Për faktin se, deklarata e tillë mbanë datë 02.11.2023, kurse hapja ka qenë me 24.10.2023.

Provë 2: Deklarata për Lot 3, nga Dauti Komerc shpk.

E dyta: Nuk ka qenë kontestuese forma e paraqitjes së deklaratës nën betim, por ka qene kontestuese dhe është, sepse konsiderohet e pa përshtatshme për shkak se, deklarata nën betim përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese, për faktin se secili dokument i dorëzuar nga OE apo GOE, ka ndërlidhje direkt me deklaratën nën betim, e që në rastin konkret, Deklarata në Betim është gabueshme dhe mashtruese sepse nuk paraqet gjendje të drejtë dhe të vërtet në lidhje me dispozitat e nenit 71, paragrafit 2 dhe nenit 26, paragrafit 26.1, germa (b) të Rregullores 01/2022, për arsye se për të njëjtin aktivitet të prokurimit, të dy grupet e lartë cekura kanë paraqitur ofertat e tyre direkt dhe indirekt në lidhshmëri me njeri tjetrin, duke krijuar konkurrencë të pa ndershme dhe të pa drejtë ne ketë aktivitet të prokurimit.

E treta: Po ashtu GOE "Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A. me seli në Shkup ka prezantuar një Licencë për depo ftohëse, por kjo do të vlente vetëm ne pajtim me kërkesat në dosje të tenderit, për produktet nga Importi duke prezantuar prodhuesin e jashtëm me ISO standarde, Licencën e prodhuesit nga Shteti ku operon Qumështorja dhe do të kishte një marrëveshje të ligjshme në mes të këtij Grupi dhe Qumështores nga Importi. Por assesi kjo Depo ftohëse nuk e plotëson dhe as nuk e zëvendëson kërkesën e tenderit që kërkohet prodhues i qumështit i dëshmuar me ISO dhe Licencë apo Vendim nga AVUK. E që AK nuk ka mundur të arsyetoj me kundër argumente dhe prova një dokument të tillë, përveç arsyetimeve të pa arsyeshme të paraqitura në refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

Po ashtu, Kërkesa për Ri-shqyrtim ka të bëjë edhe me Lot 5: Furnizimi me artikuj të ndryshëm ushqimor pasi që partneri i prezantuar në ofertë "ABRAZEN" LLC merr pjesë edhe në Grupin e ofertuesit tjetër "FANEXT" shpk & "ABRAZEN" LLC çka është përmbushë kushti që të eliminohet në të gjitha Lot-et e këtij tenderi, sepse, ka të njëjtin Titull: Furnizimi me artikuj ushqimor dhe numër të njëjtë të prokurimit Nr: UA/2016-23-9179-1-1-1.

Bazë ligjore është Deklarata mbi Themelimin e Grupit në të cilin ceket që, nuk do të dorëzojmë ofertë në procedurën e njëjtë të prokurimit duke përfshirë edhe partnerin e prezantuar në ofertë "ABRAZEN" LLC. Sepse, deklarata mbi Themelimin e Grupit, është në lidhje direkët me deklaratën në betim, sepse përshinë titullin dhe numrin e njëjtë të tenderit, e që, kjo deklaratë në rastin konkret, nuk paraqet gjendje të drejtë dhe të vërtete, sepse po ti referohemi deklaratës për themelimin e grupit, të germa (b) citojmë: një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

Prandaj, në lidhje me ketë, deklarata nen betim është dokumenti me krucial me të cilin OE betohen, se janë të përshtatshëm në përputhje me Nenin 65 të LPP-se, ngase me vullnetin e tyre pranojnë mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, çoftë për shkak të pakujdesisë të dorëzojnë çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese, sepse, secili dokument i dorëzuar nga OE apo GOE, ka ndërlidhje direkt me deklaratën nën betim, e që në rastin konkret Deklarata në Betim është gabueshme dhe mashtruese, atëherë, bazuar në ketë fakt, pretendojmë se partneri i prezantuar në

ofertë GOE “Dauti Komerc” shpk me seli në Ferizaj dhe “Dauti Komerc” SH.A dhe GOE “FANEXT” shpk & “ABRAZEN” LLC, duhet të eliminohet në të gjitha Lot-et.

Madje, Arsyetimi i AK, se kinse i referohet shembujve, është tejet i pa pranueshëm dhe i pa arsyeshëm, sepse vendimi i AK nuk duhet të mbështet në shembuj, por duhet të mbështet në dispozita ligjore, në raste të vendimeve të institucioneve kompetentë siç është OSHP-ja, në interpretime ligjore siç është Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik, apo në fakte e prova, e jo në shembuj të tillë, sepse kjo tregon për jo profesionalizëm, jo kujdes të shtuar, jo vigjilencë të duhur për shqyrtim të kërkesave të paraqitura nga Operatoret Ekonomik.

Për me tepër, po ti referohemi edhe shembujve të marrë nga AK, janë tejet të pa arsyeshëm dhe nuk kanë fare lidhmëni me rastin konkret, e sidomos të shembulli i dytë ku AK, merre si shembull Kompaninë DELL, meqë rast, AK arsyetohet se kinse sipas pretendimeve tona, dy kompani nëse ofrojnë produkte të kompanisë DELL, duhet të eliminohen të dyja, por, e vërteta qëndron ndryshe, sepse sipas shembullit konkret, kompania DELL, nuk është pjesëmarrëse edhe vet në aktivitetin e prokurimit, pra kemi te bëjmë me rast krejt tjetër, sepse ne këtë rast GOE “Dauti Komerc” shpk me seli në Ferizaj dhe “Dauti Komerc” SH.A dhe GOE “FANEXT” shpk & “ABRAZEN” LLC, janë pjesëmarrës të dy grupet në këtë titull të aktivitetit të prokurimit dhe që ka numër të njëjte të prokurimit.

Prandaj, me te drejte e kundërshtojmë vendimin e AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, sepse është nxjerrë në shkelje të Ligjit, në shkelje të interpretimeve të KRPP-se, sepse nuk i administron provat dhe, rrjedhimisht, në tërësinë e tije, Vendimi është i pa drejte, tendencioz dhe diskriminues ndaj konsorciumit tonë.

Kurse, sa i përket Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 16.11.2023, qëndrojmë fuqishme prapa kërkesës për rishqyrtim, për faktin se, AK nuk ka i ka administruar siç duhet pretendimet tona lidhur me provat dhe faktet që janë paraqitë në kërkesë për rishqyrtim dhe, rrjedhimisht nuk bënë trajtimit të barabartë, por është tërësisht diskriminues ndaj konsorciumit tonë në ketë aktivitet të prokurimit. Sepse, referuar nenit 7, paragrafët 1, 2 dhe 4 i LPP-se, ndër të tjera, garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, sepse i tërë qëllimi i normës së mësipërme është sigurimi i barabarësisë në trajtim të operatorëve ekonomik në mënyre barbaret dhe jo diskriminuese, ngase AK aplikon standarde të dyfishta në këtë rast.

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej te drejtave themelore të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë.

Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëllojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret.

Sidoqoftë, në asnjërën nga këto momente nuk u veprua konform legjislacionit në fuqi dhe, kështu Operatori Ekonomik GOE Dauti Komerc” shpk me seli në Ferizaj dhe “Dauti Komerc” SH.A, mbeti në garë, përveç se kësaj edhe tejet më i favorizuar. Dhe, rrjedhimisht, është i pa pranueshëm i pa qëndrueshëm, në shkelje të ligjit, në shkelje të interpretimeve të KRPP-se vendimi i AK për dhënie të kontratës për Lot 3 dhe Lot 5, GOE “Dauti Komerc” shpk me seli në Ferizaj dhe “Dauti Komerc” SH.A.

Dhe si përfundimi, duke pasur parasysh se jemi palë me interes juridiko material sipas nenin 4.1.26 të LPP-së, sepse jemi të përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe kemi ofruar më çmim më të ulët, sipas kritereve të vlerësimit, atëherë, bazuar në faktet, argumentet, arsyetimet, provat materiale, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që pas trajtimit të ankesës tonë të nxjerr; vendim meritor me të cilin të aprovoj ANKESEN të bazuar të paraqitur nga GOE " "HAJDINI COMERC" & "DRENA" SHPK.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 13.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 964/2023, ndërsa me datë 27.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. OE Pajtohet me rekomandimin e raportit te ekspertit ndërsa AK nuk Pajtohet, si ne vijim:

Fillimisht lidhur me pretendimin e pare dhe konstatimin e ekspertit citojmë: "… konsideroj se është në kundërshtim me nenin 72 paragrafi 3 i LPP-së, për faktin se është krijuar pas hapjes së ofertave. "Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive". Andaj , vlerësojmë pretendimi i palës në ankesë lidhur me këtë pikën e parë është qëndrueshëm."

Besojmë që të gjitha palët përfshirë edhe ekspertet shqyrtues të OSHP-së duhet të kenë parasysh të gjitha nenet dhe paragrafët e LPP-së, ku nenin 72 citojmë: Neni 72Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1.Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2.Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3.Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra në oferte ka dokumentacion të ofruar nga ofertuesi për produktet e prodhuesit Abrazen L.L.C (nëse i ka vërejtur edhe eksperti), por që nuk ka qenë e qartë për komisionin e vlerësimit arsyeja pse janë futur në ofertë rezultatet e testimit të produkteve të prodhuesit të lartcekur, pra informacioni ka qenë jo i plotë si dhe ekzistenca e dokumenteve të rezultateve të produkteve të prodhuesit Abrazen L.L.C kanë qenë në ofertë. Është e papranueshme për AQP-në që ti ndalohet kundërligjshëm komisioneve të vlerësimit të kërkojnë sqarime shtesë për të vlerësuar sa më mirë

ofertat e pranuara.

Ju informojmë edhe njëherë që OE: Abrazen L.L.C ka qenë pjese e një grupi të OE-ve që nuk eshte rekomanduar të shpërblehet me kontratë, ndërsa Grup i Operatorëve Ekonomik Dauti Komerc SH.P.K.; Dauti Komerc AD Saraj Shkup, Gërlicë, 70000, Ferizaj, Kosovë që është rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë me kapacitetet e veta, përfshirë edhe ISO standardin që është në emrin e Dauti Komerc AD Saraj Shkup dhe ku ceken edhe produktet e qumështit.

AQP konsideron që ekspertiza është e pabazuar dhe jo profesionale dhe njëkohësisht qëndron prapa vendimit të vet pasi që është shpërblyer oferta më e lirë dhe që ka plotësuar të gjitha kërkesat. Një vendim duke u bazuar në ekspertize përveç që do të ishte joligjore gjithashtu do të shkaktonte dëm buxhetit të shtetit për mbi 120,000€.

*Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0964, të pretendimeve ankimore të OE ankues, si në vijim;*

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive në platformën E-prokurimi dhe ankesën e OE ankues, duhet potencuar faktin se GOE Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A i rekomanduar për kontratë për lot 3 dhe lot 5 nga AK, përveç se ka ofertuar si grup i njëjti ka bashkangjitur edhe dokumente si; certifikatën e regjistrimit të biznesit, licencat nga AUV, ISO standardeve, ISO 22000:2018 në emër të biznesit ABRAZEN" LLC dhe pas kërkesës për sqarime kanë dorëzuar edhe deklaratën me shkrim se do te furnizohet vetëm nga prodhuesi ABRAZEN" LLC, e që ky i fundit ka ofertuar edhe si anëtar i konzerciumit GOE "FANEXT" shpk & "ABRAZEN" LLC, për të njëjtin aktivitet të prokurimit ku është rekomanduar për kontratë GOE Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A. Ky veprim i grupit të GOE Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A konsideroj se është në kundërshtim me nenin 71 paragrafi 2 i LPP-se. Për faktin se prodhuesi ABRAZEN LLC një njërën anë ka oferuar si anëtar i konzerciumit, GOE "FANEXT" shpk & "ABRAZEN" LLC, kurse në anën tjetër përmes licencave dhe ISO stantardeve është përfshirë edhe tek grupi i OE të rekomanduar për kontratë për lotin 3 dhe lotin 5 e që është Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A. citoj paragrafin 2 te nenit 71 te LPP-së. *"Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm.*

Për ta ç'artësuar më mirë këtë dilemë KRPP me dt 22.11.2022 ka publikuar në web faqen e saj interpretimin ligjor nr 18 se si veprohet në këto situata "Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor, si në vijim:"

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, një operator ekonomik për tu konsideruar i përgjegjshëm nga autoriteti kontraktues, duhet ti plotësojë të gjitha kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paragrafi 4 i nenit 68 i LPP-së lidhur me Gjendjen ekonomike dhe financiare, përcakton: *"4. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete për këtë qëllim. Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera".gjithashtu,*

Paragrafi 8 i nenit 69 të LPP-së lidhur me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, përcakton*: "8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera". ndërsa,*

Paragrafi 4 i nenit 71 të LPP-së lidhur me Grupin e operatorëve ekonomik, përcakton: *"4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 ë këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit".*

Në përputhje me dispozitat e lartë cituara, në rast se një operator ekonomik i cili operon me degët e saja në disa vende (shtete) të tjera, mund të mbështetet në kapacitetet e degëve të saja për t'i përmbushë kërkesat lidhur gjendjen ekonomike dhe financiare apo lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale duke ofruar me tender dëshmitë përkatëse dhe për këtë qëllim nuk mund të diskualifikohet i njëjti pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik.

E pa pranueshme do të konsiderohej nëse operatori ekonomik me degët e saja dorëzojnë individualisht tenderë në një aktivitet prokurimi që ka për qëllim dhënien e një kontrate publike, sepse një pjesëmarrje e tillë do të dëmtonte konkurrencën, në fakt do të krijonte konkurrencë të pa ndershme.

Gjithnjë në përputhje me dispozitat e lart cituara, është e drejtë e çdo Operatori Ekonomik i cili nuk mund ti përmbushë si i vetëm kërkesat e parashtruara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare apo lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, të mbështetet në kapacitetet e një subjekti (ve) tjetër, apo të marrë pjesë në grup të operatorëve ekonomik (konzorcium). Dallimi qëndron vetëm tek përgjegjësia. Në rastin e mbështetjes, përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është operatori ekonomik i cili mbështetet në kapacitetet e subjekteve tjera, ndërsa në rastin e Grupit të Operatorëve Ekonomik, grupi është individualisht dhe bashkërisht përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

AK në dosje të tenderit tek, kërkesa e dytë e përshtatshmërisë profesionale kishte kërkuar:Kërkesa 2: Operatori ekonomik duhet të jetë i akredituar nga institucioni i pavarur sipas ISO standardeve, ISO 22000:2018 - Food safety management systems, ose ekuivalente apo më të avancuara. Për Lot 1 dhe 2 - për mish; për Lot 3 – për qumësht; për Lot 4 dhe 5 – për produkte ushqimore; per Lot 6 dhe Lot 7 – për produkte të grurit ose për industrinë e furrës së

bukës.Dokumentet dëshmuese për përshtatshmëri profesionaleEvidenca 2**:** Certifikata që është në pajtueshmëri me standardet ISO 22000:2018; ose certifikatë *ekuivalente apo më të avancuara.*

Kërkesa 3 **t**ek kapaciteti teknik dhe profesionale dosje të tenderit është; Kërkesa 3: Të gjitha produktet ushqimore me origjine shtazore ,duhet te kenë origjinën, nga një ndërmarrje e aprovuar (licencuar) nga AUV-a (produktet vendore nga thertore/qumështoret e licencuara ose aprovuara ose Fabrikat Prodhuese të Mishit te aprovuar) (produktet nga Importi nga subjektet depo ftohëse dhe mjete transportuese adekuate te aprovuara) - KËRKOHET VETËM PËR Lot 1,2 dhe 3. Kurse dëshmia e kërkuar në dosje të tenderit është;Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionaleEvidenca 3: Si dëshmi e aprovimit Licenca ose Vendimi për Aprovim i lëshuar nga AUV për te gjitha ndërmarrjeve te biznesit me mish/qumësht , - - KËRKOHET VETËM PËR Lot 1,2 dhe 3.Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë për lot 3 dhe lot 5 Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A, për të përmbushur kërkesat e dosjes së lartcekur kishte dorëzuar me ofertë dokumentet si në vijim;1. Certifikatën e regjistrimit te biznesit të OE "ABRAZEN" LLC;2. Vendimin për aprovim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ( AUV) me nr protokolli 2440/1 faqe 2 te datës, 30.03.2018, vendim ky i lëshuar në emër të bisnesit "ABRAZEN" LLC;3. Raportet e testimit, të kontrollit dhe cilësisë së ushqimit, të lëshuara nga Instituti Bujqësor i Kosovës, edhe këro testime ishin në emër të bisnesit "ABRAZEN" LLC;4. Certifikatën ISO 22000:2018 në emër të bisnesit "ABRAZEN" LLC;

Dorëzimi i dokumenteve të lartëpërmenduara në ofertën e tij nga grupi i OE të rekomanduar për kontartë për lot 3 dhe 5 e dëshmon faktin se grupi i OE në fjalë nuk i ka përmbushur kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, por ka bashkangjitur edhe dokumentet e OE "ABRAZEN" LLC në ofertën e tyre. OE "ABRAZEN" LLC; ka ofertuar edhe si anëtar i konzerciumit tek GOE "FANEXT" shpk & "ABRAZEN" LLC për të njëjtin aktivitet të prokurimit lot 3 kurse, grupit të OE të rekomanduar për kontratë për lot 3 dhe lot 5 "Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A ju ka dhënë dokumentet e lartpërmendura. Ky veprim konsideroj se i bënë të pa përgjegjshëm të dy grupet e operatorëve ekonomik, si atë të rekomanduar për kontratë për lotin 3 dhe 5 "Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A. po ashtu edhe grupin e operatorëve tjerë ku është pjesë operatori ekonomik "ABRAZEN" LLC sepse ofertimi në këtë mënyrë, e bënë konkurrencën e pa-ndershme dhe bije ndesh me nenin 71 paragrafi 2 i LPP-së dhe interpretimin ligjor të dhënë nga KRPP-ja tek pyetja e 18.

Më tej eksperti shqyrtues sqaron se AK me dt. 02.11.2023 përmes platformës E-prokurimi kishte dërguar kërkesën për sqarime shtesë tek grupi i OE të rekomanduar për kontratë për lotin 3 dhe 5 me tekstin si në vijim; Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj. Në ofertën tuaj ju keni bashkangjitur dokumentacion të prodhuesit Abrazen LLC – "VITA". Për të sqaruar ofertën tuaj për Lot 3 kërkojmë nga ju të na sqaroni përmes një deklarate që nëse ju shpërbleni me kontratë do të furnizoni produktet e prodhuesit Abrazen L.L.C. Pra të na ofroni një deklaratë e cila do të jetë pjesë e kontratës që do ju obligoj juve që gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate të liferoni vetëm produkte të prodhuesit Abrazen L.L.C. Apo nëse bashkëngjitja e dokumenteve të prodhuesit Abrazen LLC ka pasur qëllim tjetër për ju atëherë ju lutem na sqaroni.

Bazuar në procesverbalin e hapjes se ofertave, hapja është bërë me dt. 24.10.2023 në ora 13:30, kurse në ofertën e dorëzuar, nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë, deklarata nuk ka qenë

pjese e ofertës, dokumenti apo deklarata e dhënë nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë është ngarkuar në platëformën e-prokurimi me datën 02.11.2023, po ashtu edhe vetë deklarata mbanë të njejtën datë me atë të ngarkuar në platëformën e-prokurimi pra 02.11.2023. Nga kjo, mund të kuptohet se ky dokument nuk ka ekzistuar para hapjes së ofertave, por është krijuar pas kërkesës për sqarime shtesë. Deklarata e dhënë nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë me dt 02.11.2023, se nëse ata shpallen fitues për lot 3, do të furnizojnë vetëm me produkte të prodhuara nga kompanija "ABRAZEN" LLC, konsideroj se është në kundërshtim me nenin 72 paragrafi 3 i LPP-së, për faktin se është krijuar pas hapjes së ofertave. *"Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive,* .

Lidhur me pretendimin e dytë dhe tretë. Eksperti Shqyrtues, sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive në platëformën E-prokurimi grupi i OE të rekomanduar për kontratë lot 3 dhe lot 5 ka dorëzuar me ofertë edhe vendimin e lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me numër të protokollit 4826 faqe 2 datë.01.10.2012 përmes të cilit është aprovuar kërkesa e OE Dauti Comerc shpk për depo ftohëse. Kërkesa 3 e dosjes së tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional ishte; Kërkesa 3: Të gjitha produktet ushqimore me origjine shtazore , duhet te kenë origjinën, nga një ndërmarrje e aprovuar (licencuar) nga AUV-a (produktet vendore nga thertore/qumështoret e licencuara ose aprovuara ose Fabrikat Prodhuese të Mishit te aprovuar) (produktet nga Importi nga subjektet depo ftohëse dhe mjete transportuese adekuate te aprovuara) - kërkohet vetëm për Lot 1,2 dhe 3. Kurse dëshmia e kërkuar në dosje të tenderit është.

Nga kërkesa e dosjes së tenderit, vërehet se është kërkuar që OE fillimisht duhet të jetë i licencuar e më pastaj të posedoj edhe depo ftohëse dhe mjete transportuese. Grupi i OE të rekomanduar në emër të anëtarit të konzerciumit Dauti Komerc shpk ka bashkangjitur dëshminë e depos ftohëse, ISO 22000:2018 në emër të "Dauti Komerc" SH.A me seli në Shkup, Vendimin për regjistrim të lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në emër të "Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj, por jo edhe licencat dhe ISO në emër të anëtarit tjetër "Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj. Licencat dhe ISO 22000:2018 grupi i OE të rekomanduar për kontratë për lot 3 dhe 5 i ka prezantuar të operatorit ekonomik Abrazen LLC, i cili është pjesë e grupit ekonomik për aktivitetin e njëjtë të prokurimit lot 3. Grupi i operatorëve ekonomik, ku bënë pjesë operatori ekonomik Abrazen LLC, është i përbërë nga kompanitë; GOE "FANEXT" shpk & "ABRAZEN" LLC dhe i njëjti nga komisioni i vlerësimit është vlerësuar si i pasuksesshëm për lot 3. Andaj, konsideroj se përfshirja e operatorit ekonomik "ABRAZEN" LLC, edhe në GOE "FANEXT" shpk & "ABRAZEN" LLC, dhe njëkohësisht dorëzimi i dokumenteve si Licenca dhe ISO 22000:2018 nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë për lot 3 dhe 5 në ofertën e tyre për aktivitetin e njëjtë të prokurimit, të biznesit "ABRAZEN" LLC, i bënë të papërgjeshëm të dy grupet e operatorëve ekonomik, ku është i përfshirë edhe OE "ABRAZEN" LLC, pasi që krijon konkurrencë të pa ndershme dhe është në kundërshtim me nenin 71 paragrafi2 i LPP-së. Provë ISO e dorëzuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë për lot 3 dhe 5 por që është në emër të biznesit "ABRAZEN" LLC.

Si përfundim AK – respektivisht ZPP në përgjigjen e dhënë me dt. 23.11.2023 ku ka refuzuar si të pa-bazuar ankesën e OE ankues, ndër tjera ka marr edhe disa shembuj se nëse; *"ofertojnë në një aktivitet të prokurimit dy OE le të themi me produkte të prodhuesit DELL, atëherë duhet të eliminohen të dy OE pasi që prodhuesi DELL merr pjesë indirekt në dy ofertat*". Po ashtu AK në arsyeshmërinë e vendimit të vet ka përmendur faktin se grupi i OE të rekomanduar për kontratë

për lot 3 dhe 5 OE "ABRAZEN" LLC NUK është pjesë.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, arsyeshmëria e dhënë nga AK është në kundërshtim me nenin 25 pika b, nenin 25.7 të Rregullores për prokurim publik Nr. 001/22, *Kriteret e përzgjedhjes* për arsye se këto kritere te përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike. Po ashtu është në kundërshtim edhe me nenin 26 pika d dhe nenet 26.5 dhe 26.6 të Rregullores për prokurim publik Nr. 001/22-së sepse kërkohet që; pika d e nenit 26 " *Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit*, nenin 26.5 "*Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Kurse neni 26.6 "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse".*

Kjo, për faktin se në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me atë se dy OE kanë ofertuar me produkte të njëjta, siç e përshkruan AK në arsyeshmërinë e vendimit të tij për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim si të pabazuar. Por, kemi të bëjmë me atë se prodhuesi "ABRAZEN" LLC ka dorëzuar ofertë të dyfishtë për aktivitetin e njëjtë të prokurimit. Pra OE "ABRAZEN" LLC si prodhues në njërën anë ka hyrë si anëtar i konzerciumit, ndërsa tek grupi i OE të rekomanduar për kontratë është përfshirë në mënyrë indirekte përmes dhënies së dokumenteve si; Certifikata e regjistrimit te biznesit të OE "ABRAZEN" LLC; Vendimin për aprovim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ( AUV) me nr. protokolli 2440/1 faqe 2 te datës, 30.03.2018, vendim ky i lëshuar në emër të biznesit "ABRAZEN" LLC; Raportet e testimit, të kontrollit dhe cilësisë së ushqimit, të lëshuara nga Instituti Bujqësor i Kosovës, edhe këto testime ishin në emër të biznesit "ABRAZEN" LLC; Certifikatën ISO 22000:2018 në emër të biznesit "ABRAZEN" LLC. Dokumente këto të parapara si kritere minimale të përzgjedhjes në dosje të tenderit. Andaj vlerësoj se kjo e bënë konkurrencën e pa-ndershme dhe bije ndesh me nenin 71 paragrafi 2 i LPP-së si dhe interpretimin ligjor te KRPP-së tek pyetja e 18.

Për më tepër vet AK, ka kërkuar sqarime shtesë, pikërisht për dokumentet e dorëzuar të OE Abrazen LLC – "VITA" nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë si në vijim; Ne ofertën tuaj ju keni bashkangjitur dokumentacion të prodhuesit Abrazen LLC – "VITA".Për të sqaruar ofertën tuaj për Lot 3 kërkojmë nga ju të na sqaroni përmes një deklarate që nëse ju shpërbleni me kontratë do të furnizoni produktet e prodhuesit Abrazen L.L.C. Pra të na ofroni një deklaratë e cila do të jetë pjesë e kontratës që do ju obligoj juve që gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate të liferoni vetëm produkte të prodhuesit Abrazen L.L.C.Apo nëse bashkëngjitja e dokumenteve të prodhuesit Abrazen LLC ka pasur qëllim tjetër për ju atëherë ju lutem na sqaroni.

AK, me dt. 02.11.2023, ka pranuar përgjigje nga grupi i OE të rekomanduar, një deklaratë dhe atë pas hapjes së ofertave përmes të cilës grupi i OE të rekomanduar zotohet se do të furnizoj vetëm me produkte te OE "ABRAZEN" LLC, por nuk kishte dhënë asnjë sqarim se cili ka qenë qëllimi i bashkëngjitjes së dokumenteve të OE "ABRAZEN" LLC në ofertën e tyre si;

Certifikata e regjistrimit te biznesit të OE "ABRAZEN" LLC; Vendimin për aprovim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ( AUV) me nr. protokolli 2440/1 faqe 2 te datës, 30.03.2018, vendim ky i lëshuar në emër të biznesit "ABRAZEN" LLC; Raportet e testimit, të kontrollit dhe cilësisë së ushqimit, të lëshuara nga Instituti Bujqësor i Kosovës, edhe këto testime ishin në emër të biznesit "ABRAZEN" LLC; Certifikatën ISO 22000:2018 në emër të biznesit "ABRAZEN" LLC. Po ashtu duhet cekur faktin se grupi i OE të rekomanduar për kontratë, në ofertën e dorëzuar me dt. 24.10.2023, për ta përmbushur kërkesën e dytë të dosjes së tenderit tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, ka dorëzuar ISO 22000:2018 në emër të "Dauti Komerc" SH.A me seli në Shkup, dhe ISO 22000:2018 në emër të "ABRAZEN" LLC. Pra nuk kishte dorëzuar edhe ISO 22000:2018 në emër të anëtarit tjetër te konzeciumit Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj ashtu siç e kërkon neni 26.6 i Rregullores për prokurim publik Nr. 001/22 *" Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse".*

Pavarësisht, se AK nuk kishte pranuar asnjë përgjigje se me çfarë qëllimi, ishin përfshirë dokumentet e prodhuesit "ABRAZEN" LLC, në ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë. Po ashtu edhe deklarata e dhënë nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë, se në rast se ata shpallen fitues, do të furnizojnë vetëm me produkte nga prodhuesi "ABRAZEN" LLC, ishte pas hapjes së ofertave dhe në kundërshtim me paragrafin 3 të nenin 72 të LPP-së. " *Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive".* Për kundër kësaj, AK- respektivisht komisioni i vlerësimi të ofertave-ZPP, ka rekomanduar për kontratë grupin e OE "Dauti Komerc" shpk me seli në Ferizaj dhe "Dauti Komerc" SH.A me ç 'rast konsideroj se kanë vepruar në kundërshtim me nenet; 60, dhe 59 paragrafi 4 të LPP-së, *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".* Andaj, nga konstatimet e lartë cekura etë i palës në ankesë është i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " Furnizim me artikuj ushqimor", për lot 3 dhe lot 5 aktiviteti prokurimit: UA/2016-23-9179-1-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.P "Hajdini Comerc" dhe argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.P "Hajdini Comerc" janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " Furnizim me artikuj ushqimor", për lot 3 dhe lot 5 aktiviteti prokurimit: UA/2016-23-9179-1-1-1. të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin, faktet e lartë përmendura, ankesën e operatorit ekonomik ankues, dokumentacionit të lëndës, pas analizimi te tyre e vlerëson ankesën e operatorit si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me " Furnizim me artikuj ushqimor", për lot 3 dhe lot 5, të kthehet në Rivlerësohet dhe Autoriteti kontraktues, të veproj për evitimin e gjitha shkeljeve ligjores, përkatësisht të pretendimeve ankimore të OE "Hajdini Comerc" të vlerësuara si të bazuara/qëndrueshme sipas Raportit të ekspertit shqyrtues, konstatime të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues, me dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e nenit, 60, dhe 59 paragrafi 4 , nenit 71 paragrafi 2 të LPP-së, e po ashtu me nenin, 25 pika b, nenin 25.7, 26 pika d dhe nenet 26.5 dhe 26.6, të Rregullores për prokurim publik Nr. 001/22-së, dhe Autoriteti kontraktues obligohet që në procesin e Rivlerësimit t'i eliminojnë të gjitha këto shkelje ligjore të konstatuara. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP-së dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: "Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- OE - **N.T.P "HAJDINI COMERC "**
- Arkivës së OSHP-së: